



Pranuar / Dostiguar Received/ Delivered		05 - 10	2022	2	vite years
Organ / Objekta Organ / Object	Nr. Prot. Pr. No.	Shkronja Protok. Appendix		Sasia Koliciteti Quantity	
SKIMSHK	5906	/2022		1/15	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.723/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malësore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesat e

dhe të bashkuara në një ankesë me numër A.nr.723/2022 të datës 22.08.2022 sipas Vendimit VK.Nr.24/2022 të datës 24.08.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër organit të punësimit Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, Nenin 16 paragrafi 3 dhe Nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 05.10.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.723/2022 e datës 22.08.2022 të parashtruar nga ankuesit**

dhe

**II. Shfuqizohet Vendimi Nr.138/2022 i datës 15.09.2022 për transferimin ankuesit**

Vendimi Nr.139/2022 i datës 15.09.2022 për transferimin e ankuesit

Vendimi Nr.140/2022 i datës 15.09.2022 për transferimin e ankueses

Vendimi

Nr.141/2022 i datës 15.09.2022 për transferimin e ankueses

dhe Vendimi Nr.

142/2022 i datës 26.09.2022 për transferimin ankuesit

dhe çështja kthehet në

*rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni i Ristrukturimit.*

**III. Obligohet Komisioni i Ristrukturimit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të rishqyrtoj çështjen e transferimit të ankuesve në pajtim me legjislacionin në fuqi.**

IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme ligjore-administrative për zbatimin e vendimit siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, më datë 29.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 3802/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.12/2022 të datës 10.05.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, për shkak të shkeljes së ligjit material, shkelje thelbësore të procedurës dhe vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike. Ankuesi më datë 18.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4158/2022 kundër heshtjes administrative lidhur me mos transferimin e ankuesit në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit, me pretendimin së Komisioni i Ristrukturimit nuk ka vërtetuar drejt gjendjen faktike. Ankuesi më datë 22.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4262/2022 për heshtje administrative dhe mos sistemim për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimin që procesi i ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës është përcjell me mos respektim të kriterëve në krahasim me detyrat dhe përgjegjësitë si dhe proceduarat ligjore. Ankuesi më datë 25.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4276/2022 për shkak të heshtjes administrative dhe mos sistemimit për shkak të ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Ankuesit dhe më datë 10.08.2022 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 4633/2022 kundër shpalljes së konkurseve për pozitat e Drejtorëve të Departamenteve dhe Udhëheqësve të Divizioneve në MPJD. Ankuesja më datë 22.08.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4866/2022 kundër heshtjes administrative për mos sistemim në pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Duke pas parasysh së ankesat bazohen në të njëjtën gjendje faktike dhe bazë ligjore, e në funksion të vendosjes në pajtim me parimin e efikasitetit të procedurës administrative siç përcaktohet me nenin 10 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me Vendimin VK.Nr.24/2022 të datës 24.08.2022 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është bërë bashkimi i ankesave në një ankesë me numër A.nr.723/2022.

*Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:* Ankesën me numër protokollit 3802/2022 të datës 29.06.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesja Njoftimin me numër protokollit 843 të datës 15.03.2022 nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore për ankuese; Emailin e datës 04.04.2022 nga ankuesja për Emailin e datës

01.04.2022 nga [ ] për ankuesen; Emailin e datës 27.03.2022 nga ankuesja për Kërkesë për qasje në dokumente publike e datës 08.06.2022 dhe 30.05.2022 nga ankuesja; Formularin e përshkrimit të punës për Drejtor të Departamentit për Diasporë; Raportin e punës dhe propozimet e komisionit për ristrukturimin për MPJD me numër protokolli 596 i datës 19.04.2022; Shkresë me titull propozim Nr. 6 për [ ] Vendimin me Nr. 12/2022 të datës 10.05.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Shkresë me titull formular e vlerësimit për Drejtor të Departamenti për Diasporë në Komisioni i Ristrukturimit; Akt Emërimit me numër protokolli 1610 i datës 10.09.2019 për ankuesen për Drejtor të Departamentit për Ruajtën dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë; Vendimin me numër protokolli 1723 të datës 20.11.2018 për caktimin e ankueses ushtrues detyrë i Drejtorit të Departamenti për Ruajtën dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë; Akt Emërimit me nr.Ref:293/2014 i datës 21.03.2014 për ankuesen për Udhëheqës të Divizionit për Themelimin dhe Mbikëqyrjen e Qendrave Kulturore dhe Diasporë; Vendimin me Nr. 902/2014 të datës 20.09.2013 për caktimin e ankueses ushtrues detyrë i Udhëheqës të Divizionit për Themelimin dhe Mbikëqyrjen e Qendrave Kulturore dhe Diasporë; Vendimin me numër protokolli 153 të datës 01.03.2012 për emërimin e ankueses ushtrues detyrë e Udhëheqësit të Divizionit për Integritet Evropianë dhe Koordinim të Politikave në Ministrin e Diasporës; Kontrate e marrëdhënies së punës e datës 02.02.2012 për ankuesen për Zyrtare e Personelit; Vendimin me Nr. Ref:076/2012 i datës 25.01.2012 për transferimin e ankueses në Zyrtare të Personelit; Certifikatë e marrëdhënies së punës me Nr.prto:672/2011 e datës 09.08.2011; Vendimin me Nr.756/2008 të datës 30.04.2008 për emërimin e ankuese Zyrtare për Shërbime Administrative Zyrën e Kryeministrit; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.756/2008 e datës 30.04.2008; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshme me Nrprot:183/2007 e datës 28.12.2007; Kontratën e datës 16.10.2007; Kontratën e marrëdhënies së punës me Nr.prot:332/2010 e datës 30.04.2010; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshme me Nrprot:631/2008 e datës 31.03.2008; Kontratën mbi kryerjen e punës së përkohshme me Nrprot:07/6747 e datës 06.11.2007; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës janar-gusht 2017 i datës 27.12.2017; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për periudhën 04.09-22.11.2018 i datës 14.12.2018; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës shtator-dhjetor 2019 i datës 27.12.2019; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës i datës 13.01.2021; Formular për vlerësimin për nëpunësi e shërbimit të jashtëm i datës 29.12.2021; Diplomën me Nr. 1125 e datës 14.07.2005 për ankuesen; Certifikatën e datës 29.03.2005; Diplomën me Nr.1197 e datës 15.09.2016; Ankesën me numër protokolli 4158/2022 të datës 18.07.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesi Emailin e datës 16.06.2022, 04.04.2022 nga ankuesi për [ ] Emailin e datës 01.04.2022 nga [ ] për [ ] Emailin e datës 20.05.2022 nga ankuesi për [ ] dhe Akt Emërimit me Nr. Ref.219/2014 të datës 10.03.2014 për ankuesin Vërtetimin 01 Numer:123/05 të datës 16.05.2005; Vërtetimin e datës 13.09.2004; Rekomandimi i datës 24.05.2004; Vërtetimin e marrëdhënies së punës me numër Ref:11.1.289/15 të datës 10.06.2015; Letër e datës 27.07.2004; Certifikatës e trajnimit mars 2016; Certifikatë e trajnimit qershor 2017; Certifikatë e trajnimit për periudhën 19 dhe 25.09.2019; Rekomandimin e datës 12.09.2005; Certifikatë e datës 13.06.2005; Certifikatën me Nr. 03/7001 e datës 04.01.2006; Vërtetim me Nr. 01-07-3999/17 i datës 31.01.2017; Formularin për vlerësimin për nëpunësit e

shërbimit të jashtëm për ankuesin i datës 31.12.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin i datës 29.01.2021; 27.12.2019, 20.12.2018; Përgjigje e datës 25.03.2022 për ankuesin; Certificate për periudhën 14.11.2020-18.12.2020, 12.10.2020-12.11.2020, 11.09.2020-12.10.2020 nga Shkolla për Gjuhë të huaj; Certificate për programimin A2-B-1; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 03.08.2022; Email e datës 18.02.2022 nga për Vendimin me Nr. 427 të datës 16.03.2022 për miratimin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën në MPJD; Ankesën me numër protokollin 4262/2022 të datës 22.07.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesi Email e datës 01.04.2022 nga për Email e datës 04.04.2022, 20.05.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 01.06.2022 nga ankuesi për dhe Emailin e datës 17.06.2022 nga ankuesi për dhe Zyrën e Sekretarit të MPJD; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 29.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 05.08.2022; Akt Emërimit me Nr. Ref: 1053/2014 të datës 16.07.2014 të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për Udhëheqës të Divizionit për Koordinimin dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës; Njoftimin me numër protokollin 907 i datës 18.03.2022; Email e datës 05.04.2022 nga për dhe Ankesën me numër protokollin 4276/2022 të datës 25.07.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesi Emailin e datës 23.06.2022 nga ankuesi për dhe Emailin e datës 21.06.2022 nga ankuesi për Emailin e datës 16.06.2022 nga ankuesit; Letër motivimi nga ankuesi; Emailin e datës 04.04.2022 nga ankuesi për CV-në e ankuesit; Diplomën me Nr. 1385 të datës 08.02.2006 të ankuesit; Diplomën me Nr. 127/21 të datës 10.11.2021; Certificate e datës 05.06.2009; Certificate për periudhën 27.09.2009 deri 22.12.2009; Certificate për periudhën 21-23.06.2010; Certificate e datës 11.02.2016; Certificate për periudhën 29 dhe 30.11.2010 deri 01.12.2010; Certificate për periudhë 13-16.02.2012, 07-08.02.2012; Certificate kontabilitet dhjetor 2008; Akt Emërimit me Nr. 006 të datës 05.09.2012 të ankuesit; Akt Emërimit AE.Nr.27/2021 të datës 08.04.2021; Vendimin me Nr. 3/14 të datës 04.03.2021; Vendimin me Nr Ref: 135/2016 të datës 15.02.2016; Vendimin me Nr. Ref:274/2014 të datës 30.04.2014; Vendimin me Nr.388/2018 të datës 13.07.2018; Vendimin me Nr. 413/2019 të datës 21.08.2019; Referencë e datës 10.12.2004; Vendimin me Nr. 97/08 i datës 28.07.2008; Propozim për lëvizje paralele MPJ/DO/22/14 i datës 29.04.2014; Referencë për ankuesin nga MKRS; Kontrate e marrëdhënies së punës e ankuesit e datës 19.07.2020, 01.08.2008, 05.01.2004; Rekomandimin për përtëritjen e kontratës i datës 19.07.2010; Vendimin me Nr. 116/2004 të datës 05.01.2004; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 28.07.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 05.08.2022; Njoftimin me Nr. Prt:967 të datës 21.03.2022 për ankuesin nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore; Raportin e punës dhe propozimet e komisionit për ristruktimin për MPJD i datës 19.04.2022 me propozim për aneksen për DMZP; Formularin e vlerësimin për Drejtor të Departamentit për Shërbime të Përgjithshëm; Propozimi Nr. 29 për ankuesin; Emailin e datës 22.04.2022 nga për ankuesin; Vendimin me Nr. 10/2022 i datës 10.05.2022 për transferimin për shkak të ristruktimit të në pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në MPJD; Ankesën me numër protokollin 4633/2022 e datës 10.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga ankuesit dhe Konkurs për lëvizje brenda kategorisë për

Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare, Udhëheqës i Divizionit për Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit; Drejtor të Departamenti për Çështje Ligjore dhe traktate, Udhëheqës i Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare, Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun, Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Publike dhe Digjitale, Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Kulturore dhe Sportive, Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit, Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë, Udhëheqës i Divizionit për NATO, Udhëheqës i Qendrës për Menaxhimin e Krizave, Udhëheqës i Divizionit për Korrespondenca dhe Privilegje Diplomatiqe; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 23.08.2022; Njoftimin nga udhëheqësi i Divizionit për Burime Njerëzore për ankuesit; Raporti i veçantë i punës së Komisionit të ristrukturimit për MPJD i datës 10.08.2022; Akt Emërimit me Nr. 07/2020 të datës 02.07.2020 për ankuesin Sh.Morina; Ndryshimin dhe plotësimin e Aktit të Emërimit me Nr. 072/2012 të datës 16.09.2013 për ankuesen Kërkesë/aprovim i datës 13.07.2022; Formulari i Planit Individual të Personelit i Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës për vitin 2022; Vendimin me Nr. 547/2022 të datës 02.08.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën me numër protokollit 4866/2022 e datës 22.08.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të parashtruar nga ankuesja Emailin e datës 13.06.2022, 25.07.2022, 28.07.2022 nga ankuesja për B.Isma; Kërkesën për informim rreth pozitës së Udhëheqësit të Auditmit të Brendshëm në MPJD e datës 13.06.2022 nga ankuesja për Zv. Sekretarin e Përgjithshëm të MPJD-së; Emailin e datës 15.08.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 27.07.2022 nga SIMBNJ për ankuesen; Provë shtesë nga ankuesja e datës 05.09.2022; Emailin e datës 15.07.2022, 29.04.2022, 12.04.2022 nga ankuesja për Emailin e datës 12.04.2022 nga për Vendimin me Nr. Ref:768/20198 të datës 10.09.2018; Licencë e datës 15.02.2017; Certifikatë për ankuesen me Nr. 114/2016 e datës 27.12.2016; Certifikatë e trajnimit për zyrtar të gjendjes civil për datës 13, 14 dhe 15.04.2022; Certifikatë e trajnimit maj 2022; Certifikatë e datës 18.02.2020; Certifikatën e datës 24.05.2022; Certifikatën e datës 08.06.2017; Certifikatën e trajnimit e datës 25.09.2015; Certifikatën nga The Cambridge School me Nr. 5637/10 të datës 10.08.2010; Certifikatë nga qendra e gjuhëve të huaja e datës 14.05.2022; Certifikatës të gjuhës angleze me Nr. 1/477 e datës 01.10.2001; Certifikatë trajnimi e datës 10.07.2004; Certifikatë e kursit të kompjuterëve e datës 01.02.2003; Certifikatë e datës 31.01.2008; Certifikatë trajnimi e datës 07.12.2006; Certifikatë trajnimi për periudhën 30.01-20.10.2006; Certifikatë trajnimi e datës 21.11.2008; Certifikatë e datës 10.10.2007; Certifikatë trajnimi e datës 06.05.2005; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2020 i datës 30.10.2020; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2019 i datës 30.10.2019; Formulari i vlerësimit për nëpunësit e shërbimit të jashtëm për vitin 2018 i datës 31.10.2018; Plotësim i ankesës nga ankuesja më datës 07.09.2022; Kërkesë e datës 17.12.2021 nga ankuesja; Plani Strategjik nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në MPJD; Plani Vjetor i Njesisë së Auditimit të brendshëm të MPJ për 01.01.2022-31.12.2022; CV-në e ankueses; Kërkesën e datës 04.04.2022 nga ankues për Komisionin e Ristrukturimit për MPJD; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 25.08.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 31.08.2022; Njoftimin me Nr. 970 të datës 21.03.2022 për ankuesen nga Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore; Raporti i datës 19.04.2022 për rastin e ankuese nga Komisioni i Ristrukturimit për MPJD dhe propozimi

për ankuesen; Kontratë e marrëdhënies së punës me Nr. 206/2011 e datës 11.05.2011; Kontratë e marrëdhënies së punës me Nr. 121/2009 e datës 13.05.2009; Vendimin me Nr. 110/13 të datës 24.05.2013; Certifikatën me Nr. 20/15 të datës 15.01.2002 për ankuesen; Licencë me Nr. 083/2017; Vërejtje me Nr. Ref:177/2022 të datës 25.03.2022; Certifikatës e datës 27.12.2016 për ankuesen; Certifikatë e datës 24.11.2005 për ankuesen; Certifikatën e datës 29.08.2003; Certifikatën e datës 25.09.2007; Certifikatë e datës 03.06.2010; Certifikatën e datës 02.05.2008; Certifikatën për periudhën 02-05.12.2009; Certifikatën e datës 25.09.2015; Certifikatën e datës 08.06.2017; Certifikatën e datës 31.01.2008; Certifikatën e datës 10.08.2010, Certifikatë nga Foreign Language Center e datës 14.05.2002, Certifikatë e datës 01.10.2001, Certifikatë e datës 20.10.2006; Certifikatë e datës 07.10.2006, Certifikatë e datë 01.02.2003, Certifikatë e datë 10.07.2004; Certifikatë e datë 06.05.2005, Certifikatë e datë 21.01.2008, Certifikatë e datë 10.10.2007, Certifikatë e datë 13, 14,15.04.2022, Certifikatë e datë 24.05.2022, Certifikatë e datë 18.02.2020, CV, Formular i Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm nga MPJ i datës 31.10.2017, Akt emërim nga MPJD i datës 13.06.2022, Vendim nga MPB i datës 10.05.2022, Ndryshimi dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit nga MDIS i datës 01.02.2018, Vendim nga MDIS i datës 31.01.2018, Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" i datës 09.06.2015, Diplomë e datës 19.06.2017, Formular i Vlerësimit për Nëpunësit e Shërbimit të Jashtëm nga MPJD i datës 31.01.2022, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i datës 20.01.2021, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 31.12.2019, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 24.12.2018, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 20.07.2017, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 29.12.2016, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 22.12.2015, Formular për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.12.2014, Licencë Nr:113/2018 e datës 15.02.2018, Certificate e Avancuar Profesionale për Prokurim me Nr.562 e lëshuar ne vitin 2022, certifikatë profesionale e gjendjes civile Nr:180 e datës 24.02.2022, Certificate Trajnimit e datës 13.08.2021, Certificate Trajnimit e datës 10.08.2021; Certificate Trajnimit e datës 23-24.03.2021; Certificate pjesëmarrës e datës 22.06.2021; Email e datës 30.11.2021, 19.11.2021 nga Email i datës 01.12.2020, nga Email i datës 04.12.2020 nga Email i datës 27.11.2020 nga Akademia Diplomatike; Certificate Trajnimit e datës shtator 2020, tetor 2019, shtator 2019, mars 2019, Certificate e Auditimit NR. EVP12/01 e datës 16.12.2018; Certificate Trajnimit e datës shtator 2018; Email e datës 18.09.2018, nga S.Breznica; Email e datës 01.03.2018, 28.02.2018; Certificate e pjesëmarrjes e datës 06.04.2018; Certificate e Auditimit Nr. EVP/09 e datës 25.03.2018; Certificate Trajnimit e datës Maj 2018; Certificate e Auditimit NR. EVP1/10 e datës 16.12.2018; Certificate Trajnimit e datës 29-30 nëntor 2018; Certificate e trajnimit Nr.224/2017 e datës 10.11.2017; Certificate Trajnimit e datës korrik 2017; Licencë Nr.VP-251 e datës 06.06.2017; Certificate Trajnimit e datës 11.04.2017; Certificate Trajnimit e datës prill 2017; Certificate Trajnimit 30.11.2017-03.12.2017; Certificate Trajnimit e datës 26-29, janar 2017; Certificate Auditimit Nr. EVP/AB 014 e datës 29.05.2016; Certificate Trajnimit e datës prill 2017; Certificate Trajnimit e datës 02-03 mars 2016,; Certificate Trajnimit e datës 21-24 janar 2016; Certificate Prokurimit No.032 e vitit 2015; Certifikatë Trajnimit e datës 04.05.2015; Certificate Trajnimit e datës 26-27 mars 2015; Certificate Trajnimit e datës 21-15 Nëntor 2015; Vërtetim për trajnim e vitit 2014; Certificate Trajnimit e datës 16-19.05.2013; Certificate e datës 29.11 nëntor 02.12.2013;

Certifikate Trajnimit Nr.006-2013 e datës 18-19.2013; Certificate Trajnimit e datës 27-28 shkurt 2013; Certificate NR: 201309.18-28-38 e datës 18-28 shtator 2013; Certificate Trajnimit e datës 22-23 shtator 2011 dhe 13-14 tetor 2011; Certificate e praktikës e datës 23.07.2007; Certificate Nr.022 e datës 03.11.2006; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 25.08.2022; Ankesë e datës 22.08.2022; Vendimin VK.Nr.24/2022 i datës 24.08.2022 për bashkimin e ankesave të ankuesve; Kundërshtimin e Vendimit VK.Nr.24/2022 të datës 24.08.2022 nga ankuesit; Vendimin e datës 05.09.2022 dhe 12.09.2022 lidhur me vendosjen e kërkesë për kundërshtim të parashtruar nga Njoftimin e datës 26.09.2022 nga MPJD; Vendimin me Nr. 142/2022 të datës 26.09.2022 për transferimin për shkak të ristrukturimit të ankuesit Njoftimin e datës 16.09.2022; Vendimin me Nr. 138/2022 të datës 15.09.2022 për transferimin për shkak të ristrukturimit për ankuesin Vendimin me Nr. 139/2022 të datës 15.09.2022 për transferimin për shkak të ristrukturimit për ankuesin Vendimin me Nr. 140/2022 të datës 15.09.2022 për transferimin për shkak të ristrukturimit për ankesën Vendimin me Nr. 141/2022 të datës 15.09.2022 për transferimin për shkak të ristrukturimit për ankueses

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë, *SEPSE*:

Nga vlerësimi i provave të lëndës është konstatuar se me Vendimin Nr.214/2022 të datës 01.02.2022 të Kryeministrit të Republikës së Kosovës është miratuar Rregullorja Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, e publikuar me datë 01.02.2022 në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ku me Nenin 61 të kësaj rregulloreje është përcaktuar së: "*Kjo Rregullore hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës*", dhe si rrjedhojë si rezultat i bashkimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Ministrisë së Diasporës ka pas shuarje të disa pozitave si dhe ndryshime në përshkrimin e vendeve të punës.

Me tej, nga administrimi i provave të lëndës rezulton së me Vendimin V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë (tutje DMZP-ja) është themeluar Komisioni i Ristrukturimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ndërsa Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në MPJD ka njoftuar individualisht ankuesit që në rastin konkret të ristrukturimit do të aplikohen dispozitat e nenit 54 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Sipas vendimit VPD.Nr.01/2022 të datës 16.03.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë, janë miratuar përshkrimet e detyrave të punesa për pozitat e nivelit të ulët drejtues dhe të mesëm drejtues në kuadër të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës.

Ankuesit në ankesat e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrë për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendojnë që Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës nuk ka qenë transparente në këtë proces për faktin që e njëjta nuk është informuar për hapat e sistemimit derisa ka parashtruar kërkesë për qasje në dokumente publike, rrjedhimisht është vepruar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Po ashtu pretendojnë së nuk është shteruar çdo mundësi për sistemim e nakuesve brenda kësaj ministrie.

Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesja në bazë të Akt-it të Emërimit me numër protokollit 1610 të datës 10.09.2019 ka qenë e emëruar në pozitën Drejtor i Departamentit për Ruajtjen dhe Kultivimin e Arsimit dhe Kulturës në Diasporë në ish Ministrinë e Diasporës, ndërsa sipas Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, kjo pozitë nuk është paraparë. Ankuesja bazuar në e-mailin e datës 01.04.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me shprehje të interesit, e njëjta ka shprehur interesin të sistemohet në pozitën Drejtor i Departamentit të Diasporës, e për të cilën pozitë përveç ankueses kanë shprehur interes dhe tre (3) nëpunës të tjerë. Komisioni i Ristrukturimit ka bërë vlerësimin e aplikacioneve të të gjithë të interesuarave dhe në bazë të formularit të vlerësimit ankuesja për nga vjetërsia në shërbimin civil ka marr 15 pikë, tek vlerësimet e rezultateve në punës është vlerësuar me 13 pikë, tek kualifikimet profesionale ka marr 20 pikë ndërsa tek trajnimet ka marr 11 pikë nga kjo gjithsej 59 pikë, duke u vlerësuar me më së paku pikë nga të gjithë kandidatët e interesuara, rrjedhimisht Komisioni i Ristrukturimit për pozitën Drejtor i Departamentit të Diasporës ka rekomanduar kandidatit pasi që i njëjti është vlerësuar me gjithsejtë 86 pikë, ndërsa përmes Raportit me numër protokollit 596 të datës 19.04.2022 ka bërë propozimin të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesja të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil pasi që e njëjta nuk plotëson kriteret për asnjë pozitë të lirë në MPJD. Me tej Komisioni i Ristrukturimit me Raportin plotësues me numër protokollit 615 të datës 22.04.2022, ka propozuar që ankuesja të sistemohet në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Ndërlidhur me këtë sipas e-mailit të datës 26.09.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, njësia përgjegjëse respektivisht DMZP-ja ka kthyer në rishqyrtim të Komisioni i Ristrukturimit transferimin lidhur me ankuesit dhe

Nga administrimi i provave materiale Kolegji i Këshillit ka gjetur së ankuesi në bazë të Akt Emërimit Nr.Ref.219/2014 të datës 10.03.2014, ka qenë i emëruar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në ish Ministrinë e Diasporës, e cila pozitë është paraparë edhe me Rregulloren Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, mirëpo që për këtë pozitë janë ndryshuar kriteret e vendit të punës respektivisht kualifikimet e posaçme formale ku është paraparë *Njohje e gjuhës angleze në nivelin B1-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze.* Ankuesi bazuar në e-mailin e datës 01.04.2022 të Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore lidhur me shprehje të interesit, i njëjti ka shprehur preferencë për sistemim në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit, ndërsa Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit me numër protokollit 596 të datës 19.04.2022 ka konstatuar së ankuesi ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për këtë pozitë mirëpo që i njëjti nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhës të miratuara nga DMZP-ja, kështu që mbi këtë bazë Komisioni ka bërë propozim të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesi të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse me Raportin plotësues me numër protokollit 615 të datës 22.04.2022 ka propozuar që ankuesi të transferohet në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit



për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, e cila pozitë është vendosur si e lirë në listën e pozitave të lira të përcjella nga DMZP-ja, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes Vendimit Nr.139/2022 të datës 15.09.2022 ankuesin e ka transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Avancimin e të Drejtave të Njeriut në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i provave materiale ka gjetur që ankuesit sipas Akt-it të Emërimit Nr.Ref.1053/2014 të datës 16.07.2014 ka qenë i emëruar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin dhe Përkrahjen e Investimeve të Diasporës në ish Ministrinë e Diasporës, e cila pozitë po ashtu është paraparë me Rregulloren Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës mirëpo që për këtë pozitë janë ndryshuar kriteret e vendit të punës respektivisht kualifikimet e posaçme formale rrjedhimisht si kualifikime të posaçme formale janë paraparë *Njohje e gjuhës angleze në nivelin B2-C1 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshmohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze.* Ankuesi bazuar në e-malin e datës 01.04.2022 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me shprehje të interesit, i njëjti ka shprehur preferencë për sistemim në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Koordinimin dhe Përkrahjen e Investimeve ndërsa Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit me numër protokollit 596 të datës 19.04.2022, ka konstatuar së ankuesi ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për këtë pozitë mirëpo që i njëjti nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale lidhur me njohjen e gjuhëve të miratuara nga DMZP-ja, kështu që mbi këtë bazë Komisioni ka bërë propozim të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë në që ankuesi të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse me Raportin plotësues numër protokollit 615 të datës 22.04.2022 ka propozuar që ankuesi të transferohet në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Zhvillim dhe Monitorim të Projekteve në Ministrinë e Pushtetit Lokal, e cila pozitë është vendosur si e lirë në listën e pozitave të lira të përcjella nga DMZP-ja, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes Vendimit me Nr.142/2022 të datës 26.09.2022 ankuesin e ka transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Zhvillimin dhe Koordinimin e Nismave Rajonale në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal.

Nga administrimit i provave të lëndës, Kolegji ka gjetur që ankuesi sipas Akt-it të Emërimit me Nr.006 të datës 05.09.2012 ka mbajtur pozitën Drejtor i Departamentit për Çështje Ekonomike dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar në ish Ministrinë e Punëve të Jashtme. Të njëjti me Vendimin Nr.Ref:3/14 të datës 04.03.2014 të Komisionit për Grada dhe Disiplinë i është miratuar grada diplomatike "Këshilltar" Me tej, sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi ka shërbyer në mision diplomatik/konsullor nga data 15.05.2014 deri me datë 07.04.2021, ku pas kthimit nga misioni diplomatik të njëjtit i është lëshuar Akt-i i Emërimit AE.Nr.27/2021 i datës 08.04.2021 për pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme e cila pozitë me miratimin e Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, nuk është paraparë si i tillë. Ankuesi bazuar në e-malin e datës 01.04.2022 të Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore lidhur me shprehje të interesit, i njëjti ka shprehur preferencat për sistemim në pozitën Drejtor i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme, e për

të cilën pozitë përveç ankuesit ka shprehur interes dhe kandidati në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në ish Ministrinë e Diasporës. Komisioni i Ristrukturimit ka bërë vlerësimin e aplikacioneve të kandidateve, me ç'rast në bazë të formularit të vlerësimit ankuesi për nga vjetërsia në shërbimin civil ka marr 18 pikë, tek vlerësimet e rezultateve në punës është vlerësuar me 12 pikë, tek kualifikimet profesionale ka marr 20 pikë ndërsa tek trajnimet ka marr 8 pikë nga kjo del që gjithsejti ka marr 58 pikë duke u vlerësuar me pikë me pak se kandidati tjetër i cili ka marrë gjithsej 78 pikë dhe njëkohësisht sipas Vendimit me numër 10/2022 të datës 10.05.2022 të Zëvendësues të Drejtorit të DMZP-së është transferuar në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës. Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit me numër protokollit 596 të datës 19.04.2022 ka konstatuar se ankuesi nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale të miratuara nga DMZP-ja për asnjë pozitë të lirë për Drejtor të Departamenteve në MPJD, duke dhënë propozim për Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë që ankuesi të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse me Raportin plotësues të datës 22.04.2022 ka propozuar që ankuesi të transferohet në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturë, e cila pozitë është vendosur si e lirë në listën e pozitave të lira të përcjella nga DMZP-ja, ndërsa Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë përmes Vendimit Nr.138/2022 të datës 15.09.2022 ka vendosur për transferimin e ankuesit në pozitën Drejtor i Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme në Ministrinë e Shëndetësisë.

Kolegji i Këshilli nga administrimi i provave materiale ka konstatuar që ankuesja Mybera Hyseni sipas Ndryshim dhe Plotësim të Aktit të Emërimit me nr.072/2012 të datës 16.09.2013 ka qenë e caktuar në pozitën Udhëheqëse e Divizionit të Auditimit të Brendshëm. Pas aprovimit të Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Udhëheqësi i Divizionit të Burimeve Njerëzore sipas njoftimit me numër protokollit 970 të datës 21.03.2022 ka njoftuar ankuesen se për shkak të ristrukturimit gjegjësisht bashkimit të dy ministrive janë dy nëpunës civil që mbajnë pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Auditimit të Brendshëm, rrjedhimisht do të bëhet transferimi i nëpunësit civil. Komisioni i Ristrukturimit përmes Raportit me numër protokollit 596 të datës 19.04.2022, ka konstatuar se ankuesja ka plotësuar kriteret e posaçme lidhur me arsimin dhe përvojën e punës për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Auditimit të Brendshëm mirëpo e njëjti nuk ka plotësuar kualifikimet e posaçme formale të miratuara nga DMZP-ja lidhur me edukimin e vazhdueshëm profesional-minimumi 60 orë trajnim brenda 2 vitëve të njëpasnjëshme sipas kërkesave të përcaktuara ligjore, andaj, meqenëse ankuesja nuk plotëson kriteret e posaçme për asnjë pozitë tjetër të lirë në MPJD, propozon që ankuesja të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, kurse sipas Raporti plotësues të datës 22.04.2022 propozon që ankuesja të transferohet në pozitën e Udhëheqësit të Divizionit për Raportime Financiare në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, ndërsa me Vendimin Nr. 140/2022 të datës 15.09.2022 të Zëvendësueses së Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë ankuesja është transferuar në pozitën Udhëheqës i Divizionit për Buxhet dhe Financa në Akademinë e Kosovës për Siguri Publikë.

Po nga shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur së Komisioni i Ristrukturimit sipas Raportit me numër protokollit 596 të datë 19.04.2022, ka konstatuar së ankuesja në pozitën e Drejtores së Departamentit për Hulumtime dhe Përkrahjen e Investimet të Diasporës e cila pozitë nuk është e paraparë me Rregulloren Nr. 01/2022 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, dhe pasi që e njëjta nuk plotëson kriteret e posaçme formale për asnjë pozitë punë të lirë në MPJD ka propozuar që të transferohet në një institucion tjetër të shërbimit civil, ndërsa me Raportin Plotësues të datës 22.04.2022 ka propozuar transferimin e së njëjtës në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Pensioneve në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, mirëpo, me Vendimin Nr.141/2022 të datës 15.09.2022 të njësisë përgjegjëse-DMZP-së është vendosur për transferimin e ankuses në pozitën e Drejtorit të Arkivit Ndërkombëtar në Agjencinë Shtetërore të Arkivit të Kosovës. Kurse për ankuesin në pozitën e Drejtorit të Departamentit për Diplomaci Ekonomike në ish Ministrinë Punëve të Jashtme, Komisioni i Ristrukturimit ka konstatuar së ankuesi nuk plotëson kriteret e posaçme formale të miratuar për këtë pozitë punë rrjedhimisht si kualifikime të posaçme formale janë paraparë *“Njohje e gjuhës angleze në nivelin C1-C2 (e obliguar). Njohja e gjuhës angleze, dëshimohet përmes certifikimit nga një institucion i akredituar vendor ose ndërkombëtar ose studime të kryera në një universitet vendor në gjuhën angleze ose në një universitet jashtë vendit në gjuhën angleze”*, ndërsa me Raportin plotësues të datës 22.04.2022 ka propozuar që i njëjti të transferohet në pozitën e Drejtorit të Departamentit të Tatimit në Pronë në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve, mirëpo që DMZP-ja ka rikthyer serish në rishqyrtim propozimin e Komisionit të Ristrukturimit.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore Kolegji ka konstatuar se si rezultat i ristrukturimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, ekzistojnë pozita të lira të nivelit të mesëm drejtues dhe të nivelit të ulët drejtues, për plotësimin e të cilave MPJD-ja me datë 20.07.2022 ka shpallur konkurset për lëvizje brenda kategorisë dhe rrjedhimisht sipas shkresave të lëndës rezulton së si pozita të lira të nivelit drejtues të mesëm janë: Drejtor i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate; Drejtor i Departamentit për Diplomaci Publike, Drejtor i Departamentit për NATO dhe Politika të Sigurisë, Drejtor i Departamentit për Organizata Ndërkombëtare dhe Drejtor i Departamentit të Protokollit të Shtetit, ndërsa si pozitat e lira të nivelit drejtues të ulët janë: Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Kulturore dhe Sportive, Udhëheqës i Divizionit për Diplomaci Publikë dhe Digjitale Udhëheqës i Divizionit për Komunikim me Publikun, Udhëheqës i Divizionit për Korrespondenca dhe Privilegje Diplomatie, Udhëheqës i Divizionit për Mbikëqyrjen dhe Zbatimin e Legjislacionit, Udhëheqës i Divizionit për NATO, Udhëheqës i Divizionit për Organizata Ndërkombëtar, Udhëheqës i Divizionit për Organizatën e Kombeve të Bashkuar, Udhëheqës i Divizionit për Politika të Sigurisë, Udhëheqës i Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare, dhe Udhëheqës i Qendrës për Menaxhimin e Krizave. Lidhur me këto pozita drejtuese, e duke u bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të aprovuara nga DMZP-ja, është konstatuar së lidhur me kërkesat e përgjithshme formale përveç kriterit të arsimit dhe të përvojës, duke marr parasysh specifikat e shërbimit të jashtëm janë përcaktuar si kualifikime të posaçme formale njohja e gjuhëve të huaja.

Në kuptim të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore Kolegji ju referua Nenit 7 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë ku përcaktohet se: *“Menaxhimi i marrëdhënies juridike me*

*nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë” si dhe nenit 32 paragrafi 3 po të të njëjtit ligj me të cilin parashihet se: “3.Themelimi, ndryshimi apo përfundimi i marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil bëhet vetëm sipas këtij ligj”.*

Po ashtu në funksion të shqyrtimit të themelësisë së pretendimeve ankimore të ankuesve, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat ligjore lidhur me çështjet e ristrukturimit përkatësisht:

*Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, nenin 54 ka përcaktuar se: Nëse për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, pozita e mëparshme e një nëpunësi civil shuhet, ai mund të transferohet në një pozitë tjetër të Shërbimit Civil të së njëjtës kategori. 2. Transferimi, sipas paragrafit 1 të këtij neni, mund të bëhet: 2.1. në të njëjtin institucion, ku nëpunësi civil është i emëruar; 2.2. në institucionin në të cilin është bashkuar, në institucionin që është ndarë apo në institucionin që ka marrë funksionet që kryente më parë nëpunësi; 2.3. në agjencinë ekzekutive të institucionit të ristrukturuar; 2.4. në një institucion tjetër të Shërbimit Civil. 3. Në çdo rast shuarje apo ristrukturimi të institucionit krijohet një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë, në të cilën ai i plotëson kërkesat e veçanta. Vendimi përfundimtar i transferimit merret nga njësia e pranimit, në bazë të propozimit të komisionit. 4. Nëpunësi mund të refuzojë transferimin vetëm për arsyet e parashikuara në paragrafin 3 të nenit 52 të këtij ligji. Refuzimi i transferimit për arsye të tjera përbën shkak për lirin nga Shërbimi Civil. 5. Komisioni i ristrukturimit, i parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni, drejtohet nga njësia e pranimit dhe në të bëjnë pjesë përfaqësues të institucioneve të parashikuara në paragrafët 2.1, 2.2, 2.3 dhe 2.4 të këtij neni, sipas rastit....”*

*Rregulloren (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, neni 13 ka përcaktuar se: Raste të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit do të konsiderohen ndryshimet e vendeve të punës rastet në të cilat, për efekt të shuarjes apo ristrukturimit të ndodhur në institucion: 1.1. janë shkurtuar vende pune; 1.2. janë ristrukturuar vende pune; 1.3. kanë ndryshuar kriteret e vendeve të punës. 2.Në rast se paraqiten rastet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, nëpunësit civilë sistemohen në vendet e reja të krijuara, të ristrukturuara apo të mbetura si pasojë e ristrukturimit apo shuarjes së institucionit, në të njëjtën kategori, në njërin nga institucionet e përcaktuara në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit. 3. Nëpunësit e institucionit të ristrukturuar apo të shuar njoftohen individualisht nga Njësia e Burimeve Njerëzore për fillimin e procedurës së transferimit për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit, menjëherë pas miratimit të aktit të ristrukturimit apo mbylljes së institucionit. Në nenin 14 përcaktohet së : Në rastet e shuarjes apo ristrukturimit, njësia përgjegjëse brenda 15 dite të aktit të ristrukturimit krijon një komision ristrukturimi, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese dhe propozon transferimin e nëpunësit në një pozitë të lirë të së njëjtës kategori..... 3. Komisioni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e themelimit i propozon me shkrim njësisë përgjegjëse transferimin e nëpunësit civil siç parashihet në Nenin 54. paragrafin 2 të Ligjit; 4. Komisioni në propozimin e tij për transferimin e nëpunësve civilë për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit mbështetet në kriteret specifike të vendeve të lira apo të atyre të krijuara dhe kualifikimet dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Vendimi është individual për çdo nëpunës civile. 5. Komisioni gjatë transferimit të nëpunësve civil për shkak të shuarjes apo ristrukturimit të institucionit cakton prioritetin e transferimit dhe mbështetet mbi këto kriteret: 5.1. vjetërsinë e nëpunësit civil në shërbimin civil; 5.2. vlerësimet e rezultateve në punë të nëpunësve civilë ; 5.3. kualifikimet profesionale të nëpunësve civilë.*

5.4. trajnimet. 6. Komisioni i ristrukturimit cakton peshën specifike të kriterëve të përcaktuara në paragrafin 5 të këtij neni dhe metodologjinë e vlerësimit të secilit kriter.

Andaj, Kolegji i Këshillit në kuptim të dispozitave ligjor si me lartë dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës ka konstatuar së Komisioni i Ristrukturimit i formuar sipas Vendimit V.nr.1/KR/2022 të datës 24.02.2022 të Zëvendësueses së Departamentit për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë është i përbërjen në pajtim me nenin 54 paragrafi 5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe si njëjti ka zbatuar procedurën e prioriteteve sipas kriterëve të përcaktuar me nenin 14 paragrafi 5 të Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë, mirëpo, bazuar në shkresat e lëndës Kolegji vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit nuk ka vërtetuar në mënyrë të plotë gjendjeve e fakteve dhe në këtë mënyrë gabimisht ka zbatuar dispozitat material, sepse, sipas Kolegjit raportet e komisionit nuk përmbajnë sqarim lidhur me faktet dhe rrethanat që kanë qenë vendimtar në vendimmarrj përkatësisht Komisioni i Ristrukturimit me rastin e propozimeve për transferimin e ankuesve në pozitat përkatëse në institucionin tjetër, nuk ka evidentuar kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të përcaktuara për pozitat në fjalë dhe nëse ankuesit kanë plotësuar këto kriterë, si një nga kërkesat bazë ligjore për transferim në rast të ristrukturimit.

Ndërlidhura si me lart, Kolegji vlerëson së Komisioni i Ristrukturimit me rastin e konstatimit së ankuesja dhe nuk kanë plotësuar kriterin e kualifikimeve të posaçme formale lidhur me edukimin e vazhdueshëm duke mohuar të drejtën e transferimit në pozitën e Udhëheqësit të Njesisë së Auditimit të Brendshëm, nuk ka vërtetuar drejt këtë fakt sepse ankueset kanë plotësuar kriteret dhe kualifikimet për këtë pozitë punë siç janë të përcaktuara me neni 22 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike ku shprehimisht theksohet së auditorët e njesisë së auditimit të brendshëm duhet të kenë kualifikimet si në vijim: *2.1 diplomë universitare në ekonomi, juridik, administratë publike, financa publike apo fusha të tjera të studimeve relevante për sektorin që do të auditohet; 2.2. certifikatë të auditorit të brendshëm në sektorin publik, e lëshuar nga Ministria e Financave ose certifikatë për auditor të brendshëm në sektorin publik nga ndonjë institucion relevant ndërkombëtar apo vendor në pajtueshmëri me kriteret e nxjerra nga Ministri i Financave, dhe si rrjedhojë edukimi i vazhdueshëm profesional sipas nenit 25 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të këtij ligji është përcaktuar si obligim i Drejtorit të Njesisë së Auditimit të brendshëm dhe auditorëve të brendshëm në ushtrim të funksioneve dhe vazhdim të certifikimit, ndërsa përgjegjës për të siguruar trajnime lidhur me zhvillim e vazhdueshëm profesional të auditorëve të brendshëm është Njësia Qendrore Harmonizuese siç përcaktohet me Nenin 30 paragrafi 3 nënparagrafi 3.4 të Ligjit Nr.06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave ku theksohet se: *Njësia Qendrore Harmonizuese është përgjegjëse për hartimin dhe administrimin e politikave kombëtare për trajnimin, certifikimin dhe për zhvillim të vazhdueshëm profesional të auditorëve të brendshëm, sipas praktikave ndërkombëtare në fushën e auditimit të brendshëm; si dhe për organizimin e trajnimeve; dhe rrjedhimisht Komisioni i Ristrukturimit me rastin e vlerësimit të kriterëve të ankuesve nuk ka marrë fare në konsideratë dispozitat ligjore si ma lartë dhe nuk ka arrit të vërtetoj nëse janë siguruar trajnime për edukim të vazhdueshëm të autoret e brendshme nga njësia përgjegjëse.**

Po nga vlerësimi i provave materiale lidhur me këtë çështje juridike-administrative, Kolegji vëren kundërthënie në mes të Raporti të Komisionit të Ristrukturimit dhe vendimeve për transferimin e ankuesve nga Njësia Përgjegjëse (DMZPJ-ja), pasi që sipas Raportit të Komisionit

të Ristrukturimit të datës 22.04.2022, ankuesit ishin propozuar të transferohen në pozita të caktuar ndërsa njësia përgjegjëse në të gjitha rastet kishte lëshuar vendime për sistemim gjegjësisht transferim të ankuesve në pozicione tjera nga ato të propozuara nga Komisioni i Ristrukturimit, dhe rrjedhimisht mbi këto arsye Kolegji vlerëson së njësia përgjegjëse në procesin e transferimit të stafit për shkak të ristrukturimit të institucion bart detyrimin e lëshimit të vendimeve përfundimtare për transferim në pajtim me rekomandimet e Komisionit të Ristrukturimit dhe së çdo ndryshim i vendimeve të transferimit mund të behet vetëm në pajtim me nenin 15 paragrafi 3 të Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civil.

Nga shqyrtimin i prova materiale lidhur me çështjen në shqyrtim dhe vendosje, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së njësia përgjegjëse në këtë rast DMZP-ja ka vepruar në kundërshtim edhe me dispozita e nenit 15 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores (QRK)-Nr.14/2020 për Transferimin e Nëpunësve Civilë me të cilat është përcaktuar se: *Njësia përgjegjëse, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e marrjes së propozimit nga Komisioni i Ristrukturimit, vendos për transferimin e nëpunësit civil, njofton nëpunësin civil për vendimin dhe merr mendimin e tij me shkrim. Nëpunësi civil duhet të japë mendimin e tij me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit. 2. Nëpunësi ka të drejtë të refuzojë vendimin dhe të dëgjohet nga njësia përgjegjëse, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit për vendimin, në rastet e përcaktuara me Nenin 52. paragrafin 3 të Ligjit. Përkatesisht sipas shkresave të lëndës si dhe nga vendimet lidhur me transferimin e ankuesve nuk është vetëtuuar fakti se njësia përgjegjëse ka ndonjë mendim të ankuesve lidhur me vendimet për transferim.*

Kolegji i Këshillit bazuar në analizimin e procedurës së transferimit, po ashtu verën së procesi i ristrukturimit është përcjell me trasnparencë jo të mjaftueshme sepse përveç njoftimit të stafit lidhur me miratimin e Rregullores Nr.01/2022 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe që do të behët procesi i transferimit për shkak të ristrukturimit, në shkresat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi tjetër që ankuesit të jenë njoftuar në vazhdimësi me ecurinë e këtij procesi, kështu që mbi këto arsye Kolegji vlerëson së nuk janë respektuar parimet bazë të informimit dhe transparence gjegjësisht neni 24 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06.L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se: *"Zyrtari publik ka të drejtën të informohet për fillimin e çdo procedure dhe çdo vendimmarrje, që ka të bëjë me marrëdhënien e tij të punës"*, dhe nenin 9 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *1. Organet publike duhet të veprojnë me transparencë. 2. Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj. 3. Të drejtat e parashikuara nga ky nen, kufizohen me ligj, kur është e domosdoshme për mbrojtjen e informacionit të klasifikuar, të të dhënave personale apo të dhënave afariste e profesionale, të mbrojtura sipas ligjit, kështu që Kolegji vlerëson së janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesve.*

Bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së procedura e transferimit të ankeusve përfshirë edhe vendimet për transferim përbejnë të meta të tilla që pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së tyre, kështu që Komisioni i Ristrukturimit në ri procedurë duhet rishqyrtoj çështjen e transferimit të ankuesve, të shteroj të gjitha mundësi e sistemit të ankuesve në kuadër të institucion duke pas parasysh edhe përfundimin e konkurseve të

shpallura me datë 20.07.2022, duke propozuar sistemin e ankuesve në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

#### **Këshillë juridike:**

*Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

### **KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS** **Lënda me numër A.nr.723/2022**

**Avdyll BEKTESHI**

*[Signature]*  
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit

#### **Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesve
- Komisionit për Ristrukturim në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Zëvendësueses së Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtaresve Publikë;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së